



Planuar / Dorezuar Priljeho/Prodato Received/Delivered	23.08.2023	3	viti god year
Organ /Njesta Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAM8HCK	5791/2023		1/2



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.989/2023

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Ardita Haxhnikaj – Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi – Bajraktari, anëtarë; me Ardita Perëuku Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, si procesmbajtëse, sipas ankesës A.nr.989/2023, të datës 14.07.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit: Komuna e Pejës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.08.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** nër të vendosur lidhur me ankesën A.nr.989/2023, të datës 14.07.2023, të parashtruar nga ankuesja

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës.

### A r s y e t i m

Ankuesja me datë 14.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5244/2023, në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes të datës 13.06.2023, të Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës, lidhur me kërkesën e ankueses të datës 08.06.2023 për ekuivalentimin e pagës, nga klasa “Profesional 3” në kasën “Profesional 2”.

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i provave të lëndës ka konstatuar faktin së ankuesja është e punësuar në Komunën e Pejës dhe së e njëjta sipas Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar me numër Nr.01-112-187952, të datës 29.12.2016, është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës “Shpërndarëse e Postes”.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se; “...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunësi administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se “Përveç sa parashkohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri



81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës” rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Kontratën e Punës me numër nr.01-112-187952 të datës 29.12.2016, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita “Shpërndarës Poste”, hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo teknik dhe mbështetës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson faktin se nëpunësi administrativo-teknik dhe mbështetës, fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj, pas konstatimi së ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji vlerëson së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, kështu që mbi këtë bazë, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses

Marr parasysh konstatimin si me lartë, se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 989/2023 të datës 14.07.2023 dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që linda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër këtij vendimi të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.989/2023

Ardita Perçuki Shyti

Procesmbajtëse



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuese;
- Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

